



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i **Gjuhësisë** në Fakultetin e Shkencave Humane në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për nevojat e tij, për mbulimin e procesit mësimor, për vitin akademik 2025-2026, semestri i II-të, shpall konkurs për personel akademik me kohë të pjesshme të kategorisë profesor, asistent-lektor.

Kriteret e **përgjithshme e të veçanta** të konkurrimit për 1(një) pozicion pune të kategorisë *profesor*:

1. Kandidati të mbajë të paktën titullin shkencor “Profesor i asociuar” në fushën e Gjuhësisë, (Titulli akademik i lëshuar nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në Shqipëri);
2. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare brenda ose jashtë vendit (Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të) në Shkenca Humane në fushën *Gjuhësisë*, (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në Shqipëri);
3. Kandidati duhet të jetë i specializuar në fushën e gjuhësisë teorike;
4. Referimet dhe botimet të jenë në këto fusha;
5. Të jetë i gatshëm të përfshihet në mësimdhënie sipas orarit të përcaktuar nga drejtuesi i departamentit, sekretaria, pa kufizim kohor gjatë një dite mësimore.
6. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE-së (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), të mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi;
7. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna;
8. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
9. Të jetë i aftë për punë;
10. Leje nga punëdhënësi për ushtrimin e mësimdhënies në UE.

Kriteret e **përgjithshme e të veçanta** të konkurrimit për 1 (një) pozicion pune të kategorisë *asistent-lektor*:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare brenda ose jashtë vendit (Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të) në Shkenca Humane, fusha *Gjuhësi*, me specialitet në *gjuhësi teorike dhe gjuhësi e zbatuar*, me notë mesatare mbi 8.0. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në Shqipëri);
2. Kandidati duhet të jetë i specializuar në fushë të *gjuhësi teorike dhe gjuhësi e zbatuar*;
3. Referimet dhe botimet të jenë në këto fusha;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

4. Të jetë i gatshëm të përfshihet në mësimdhënie sipas orarit të përcaktuar nga drejtuesi i departamentit, sekretaria, pa kufizim kohor gjatë një dite mësimore.
5. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE-së (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), të mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi;
6. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna;
7. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
8. Të jetë i aftë për punë;
9. Leje nga punëdhënësi për ushtrimin e mësimdhënies në UE;

Kandidatët **duhet të dorëzojnë** nga data **29.01.2026** deri **07.02.2026** këto dokumente:

1. Kërkesë me shkrim (Plotësimi i formularit të aplikimit)
2. Jetëshkrimi.
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në Shqipëri).
4. Dokumentacionin shoqërues përkatës origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura etj.
5. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti)
7. Raporti i aftësisë në punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetësore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE.

Përveç konkurrimit me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen *intervistës me gojë* në departament.

Dokumentacioni i kërkuar mund të dorëzohet në **rrugë postare** për periudhën **29.01.2026** deri **07.02.2026**.

Adresa postare:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
Rruga “Ismail Zyma”
Aplikim në Fakultetin e Shkencave Humane
Departamenti i Gjuhësisë
Elbasan**